



TË DREJTAT E DETYRIMET E PËRFITUESVE TË NDIHMËS SOCIALE DHE NJOHJA E DETYRIMIT PËR TË KTHYER TË HOLLAT

Përkthim për informacion. Në rast dyshimi, vetëm versionet origjinale në frëngjisht e në gjermanisht merren parasysh.

Përditësuar në prill 2017

1. Bazat ligjore kryesore

- Constitution fédérale (RS 101) / « Kushtetuta federale »
- Code pénal suisse (CP), du 21 décembre 1937 (RS 311.0) / « Kodi penal zviceran. » i 21 dhjetorit 1937
- Loi fédérale sur la compétence en matière d'assistance des personnes dans le besoin (LAS), du 24 juin 1977 (RS 851.1) / « Ligji federal mbi kompetencën përsonale të asistencës për personat në nevojë. » i 24 qershorit 1977
- Loi cantonale sur l'intégration et l'aide sociale (LIAS), du 29 mars 1996 (RSV 850.1) / « Ligji kantonal për integrimin dhe ndihmën sociale » i 29 marsit 1996
- Règlement d'exécution de la loi cantonale sur l'intégration et l'aide sociale (RELIAS), du 7 décembre 2011 (RSV 850.100) / « Rregullorja për zbatimin e ligjit kantonal për integrimin dhe ndihmën sociale. » i 7 dhjetorit 2011
- Loi cantonale sur la procédure et la juridiction administratives (LPJA), du 6 octobre 1976 (RSV 172.6) / « Ligji kantonal për procedurën administrative dhe juridiksionin. » i 6 tetorit 1976.
- Directives du Département en charge des affaires sociales (www.vs.ch/web/sas) / « Direktivat e Departamentiit të çështjeve sociale. »
- Recommandations de la Conférence suisse des institutions d'action sociale (CSIAS) (www.csias.ch), à titre subsidiaire / « Rekomandimet e Konferencës Zvicerane të institucioneve të veprimtari social (CSIAS) (www.csias.ch), si ndihmë plotësuese.

2. Të drejtat kryesore të kërkuesit/ përfituesit të ndihmës sociale

2.1 E drejta për jetesë minimale (neni 12 Kushtetuta federale, 1 LIAS, 1 e 8ss RELIAS)

- Çdo person që nuk mund të sigurojë jetën e tij në mënyrë të mjaftueshme dhe në kohë, me mënyrat e tij, ka të drejtën e ndihmës sociale. (neni 12 Kushtetuta federale). Borxhet nuk merren përsipër.
- RELIAS (neni 8 deri në 13) fikson principe të veçanta për grupe të veçanta personash (të rinj të rritur, persona në shkollë, të pavarur, pronarë të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, persona me leje qëndrimi L, persona pa leje qëndrimi).

2.2 Kërkesa për ndihmë sociale (neni 12 LIAS, 28ss RELIAS)

- Kërkesa mund të bëhet nga vetë personi ose nga përfaqësuesi i tij.
- Ajo bëhet me gojë ose me shkrim, në komunën ku banon personi (vendi ku personi jeton me të vërtetë) ose në qendrën shëndetësore (CMS).

2.3 E drejta për të marrë një vendim (neni 4 dhe 13 LIAS, 31s RELIAS, 29 LPJA)

- Komuna është përgjegjëse për të marrë vendime lidhur me ndihmën sociale. Megjithatë ajo mund t'ia delegojë këtë detyrë edhe qendrës shëndetësore (CMS) (neni 4 LIAS).
- Të gjitha vendimet komunale (e drejta për ndihmë sociale, modifikimi i buxhetit bazë, heqja e një të drejte, shlyerja e një shume ndihme, etj) duhet të jenë të motivuara dhe i njoftohen personit përkatës, duke i treguar rrugët dhe afatet e ankesës.
- Vendimi duhet të bëhet i njohur brenda **30 ditëve** që nga paraqitja e kërkesës. Ajo përcakton nëse ndihma është pranuar dhe sa është shuma. Nëse është hartuar një buxhet, ai është i bashkangjitur.
- Nëse personi bën një kërkesë të drejtpërdrejtë, komuna mund t'i kthejë një vendim për masa urgjente, brenda **5 ditëve** që nga paraqitja e kërkesës për ndihmë, në pritje të një vendimi përfundimtar.

2.4 E drejta e ankesës (neni 14 LIAS, 33 RELIAS, 5, 34 dhe 41ss LPJA)

- Personi që ka të bëjë me një vendim komunal mund ta kundërshtojë atë pranë Këshillit të Shtetit « Conseil d'Etat, Palais du Gouvernement, 1950 Sion ». Ai paraqet një ankesë në formë të një letre të nënshkruar, duke theksuar cili është vendimi i kontestuar dhe arsyet e këtij kundërshtimi. Personi mund të kërkojë që të jetë përfitues i masave urgjente.
- Afati i fundit për ankesë është 30 ditë nga dita, kur personi ka marrë vendimin. Nëse komuna nuk ka marrë një vendim brenda afatit ligjor, (sh pikën 2.3), konsiderohet të ketë marrë një vendim negativ (neni 5 LPJA). Në këtë rast personi mund të bëjë një ankesë për refuzim për të marrë një vendim, në një afat të arsyeshem.
Shërbimi i veprimit social (le Service de l'action sociale) Avenue de la Gare 23, 1950 Sion, është i ngarkuar për shqyrtimin e kërkesave kundër vendimeve komunale.

2.5 E drejta për të konsultuar dosjen e tij dhe për t'u dëgjuar (neni 19 dhe 25 LPJA)

- Me kërkesë, personi në fjalë ka të drejtë të konsultojë dosjen e tij të ndihmës sociale.
- Personi mund të shprehet për të gjitha pikat e vendimeve që kanë të bëjnë me të.
- Personi ka të drejtë të marrë një kopje të dokumenteve që nënshkruan.

2.6 Fillimi i të drejtës për ndihmë sociale.(neni 15s RELIAS)

- Nëse personi ka të drejtë për ndihmë, shqyrtimi i kësaj së drejte fillon në parim ditën, kur është paraqitur kërkesa. (shiko pikën 2.2).
- Nëse kërkesa është paraqitur gjatë muajit, llogaritja bëhet sipas kohës (në varësi të numrit të ditëve). Përndryshe, komuna mund të marrë në ngarkim krejt qiranë e muajit të parë, nëse ajo nuk është paguar akoma.
- Komuna i cakton një afat personit për të paraqitur dokumentet e domosdoshme për shqyrtimin e së drejtës për ndihmë dhe të sasisë së ndihmës financiare.(gjendja financiare personale, mjekësore, shoqërore) (shiko pikën 3.2).
- Nëse disa dokumente, për arsye të kuptueshme, nuk mund të paraqiten para afatit të 30 ditëve, komuna merr vendim për ndihmë të përkohshme, bazuar në dokumentet e paraqitura.
- Nëse personi nuk i paraqet informacionet dhe dokumentet në afatin e caktuar, pa ndonjë motiv të arsyeshem, e për këtë shkak, gjendja reale nuk mund të shqyrtohet në kohën e duhur për të marrë një vendim, komuna mund të refuzojë përkohësisht dhënien e ndihmës sociale. Nëse personi paraqet më vonë informacionet/dokumentet, e drejta për ndihmë do të analizohet prej ditës kur janë paraqitur ato e jo prej momentit, kur është paraqitur kërkesa për ndihmë.

2.7 Pagesa e ndihmës sociale (neni 16 RELIAS)

- Personi ka të drejtë të përfitojë ndihmë sociale gjatë ditëve të para të muajit, për muajin në të cilin ndodhet. Sipas gjendjes ose situatës ndihma mund të derdhet si paradhënie.
- Autoriteti i ndihmës sociale mund të paguajë drejtpërdrejt disa faktura (për shembull qiranë, shërbimet mjekësore, sigurimin e përgjegjësisë civile dhe të familjes.

3. Detyrimet kryesore të kërkuesit/përfituesit të ndihmës sociale

3.1 Plotësimi i ndihmës sociale (neni 2 dhe 19a al. 3 LIAS, 1s dhe 43 RELIAS)

- Ndihma sociale plotësimi i të gjitha burimeve të të ardhurave dhe shumave e pasurisë.
- Personi duhet të ndërmarrë të gjitha hapat që të mund të përfitojë një burim financiar (rrogë, sigurim shoqëror ose privat, pension ushqimor, ndihma familjare, borxh ushqimor nga të afërm me të ardhura, trashëgimi etj) dhe të pranojë çdo propozim të përshtatshëm për punë. Nëse ai nuk e bën këtë, ose nëse ai heq dorë nga një pasuri, komuna përfshin në buxhet (nëse është e nevojshme për disa muaj) një të ardhur hipotetike që korrespondon me shumën prej së cilës personi ka hequr dorë ose që i është hequr. Princiipi i proporcionalitetit duhet të respektohet.
- Nëse personi është pronar i një pasurie të paluajtshme, ai duhet të pranojë ta regjistrojë një hipotekë, me qëllim që të garantojë shlyerjen e ndihmës sociale.

3.2 Detyrimi për të dhënë informata dhe informacione (neni 12 LIAS, 24 dhe 29s RELIAS)

- Kërkuesi i ndihmës sociale duhet të tregojë nevojën e tij, pra duhet duhet të paraqesë situatën e tij financiare të detajuar (të ardhurat, pasurinë,e luajtshme e të paluajtshme, etj). Ai duhet të shpjegojë situatën e tij profesionale, shoqërore, personale (veçanërisht të deklarojë të gjithë personat që jetojnë me të) dhe mjekësore (në rast nevojë, me certifikatë mjekësore për ta vërtetuar atë).
- Informacionet duhet të transmetohen në afatet e caktuara nga shërbimi social (shih pikën 2.6) për të gjithë personat të së njëjtës familje (ose partner) që bëjnë pjesë në familje, po ashtu edhe fëmijët që varen prej tij, edhe në rast se jetojnë diku tjetër.
- Përfituesi i ndihmës duhet të informojë pa vonesë autoritetin e ndihmës sociale për çdo ndryshim të rrethanave. Nëse ai nuk e bën këtë dhe komuna ka një dyshim për ndihmën, ajo mund mund të marrë një vendim për pezullim të përkohshëm të pagesës së ndihmës sociale dhe fikson një afat për transmetimin e informacioneve/dokumenteve të nevojshme.

3.3 Bashkëpunimi në riintegrim (neni 11 LIAS, 18ss RELIAS)

- Përfituesi duhet të ndërmarrë gjithshka mund të kërkohe në mënyrë të arsyeshme prej tij, për të arritur autonominë e tij financiare dhe riintegrimin e tij social.
- Ai duhet të bashkëpunojë me autoritetet dhe organizmat që ndihmojnë në rimarrjen e kësaj autonomie, veçanërisht sigurimet shoqërore (invalidor (AI), papunësia (chômage), SUVA, etj.) dhe private dhe të pranojë masat e ndryshme që i propozohen. Nëse ka një kapacitet për punë, qoftë edhe të pjesshëm ai duhet të regjistrohet në papunësi (chômage) si kërkues pune (pavarësisht nga çdo e drejtë për ndihmë ditore), të mbikëqyret nga një këshilltar të ORP dhe t'i transmetojë atij kërkimet për punë.

3.4 Strehimi

- Komunat fiksojnë rregullisht një masë të qirasë mesatare bazuar në terren dhe ua komunikojnë përfituesve të ndihmës sociale, sipas kërkesave. Nëse qiraja e një përfituesi të ndihmës është shumë e lartë, komuna mund t'i kërkojë, me shkrim, të ndërrojë banesë, brenda një kohe të mjaftueshme.
- Nëse, në përfundim të afatit, personi refuzon të ndërrojë banesë, ose nëse nuk provon se ka bërë kërkime për një banesë të përshtatshme, komuna mund të refuzojë të marrë përsipër shumën e qirasë që tejkalon shumën e caktuar si masë.
- Nëse personi paguan vetë qiranë, ai duhet t'i prezantojë autoritetit të ndihmës sociale provën e pagesës mujore.

3.5 Kthimi i ndihmës sociale. (neni 21ss LIAS, 48ss RELIAS)

- Personit që ka marrë ndihmë sociale, pas arritjes së moshës madhore, i kërkohe që ta kthejë atë, pa interes. Veçanërisht nëse ka arritur të ketë të ardhura të konsiderueshme e kjo sipas ligjit të ndjekjes për borxhe dhe falimentim (la loi sur la poursuite pour dettes et la faillite) (LP). Shumat e përfituara padrejtësisht duhet të kthehen në çdo kohë dhe me interes.
- Ky detyrim mbetet në fuqi njëzet vjet derdhjes së pagesës së fundit. Nëse komuna dhe përfituesi nuk arrijnë një marrëveshje mbi mënyrat e kthimit, komuna merr një vendim zyrtar për të cilin personi mund të bëjë ankesë pranë, këshillit të Shtetit (Conseil d'Etat) (shih pikën 2.4).
- Nuk ka asnjë detyrim kthimi, kur dosja është hapur në emrin e një të mituri ose të riu deri në përfundim të formimit të tij profesional.
- Në rast se ndihma sociale është derdhur si paradhënie e një pagese për një palë të tretë ose një sigurim shoqëror apo privat, përfituesi nënshkruan një cedim në favor të autoritetit të ndihmës sociale. Kthimi është i detyrueshëm sapo bëhet pagesa, në shumën e ndihmës së dhënë, gjatë periudhës së përcaktuar për detyrim për kthim. Falë cedimit, autoriteti merr direkt shumën e sigurimit ose të palës së tretë. Nëse pagesa prapavepruese i derdhet marrësit të ndihmës, ky i fundit njofton autoritin e ndihmës sociale dhe i kthen menjëherë shumën e detyruar.

4. **Dyshimet për përfitim të paligjshëm të ndihmës sociale (neni 12 dhe 15b ss LIAS)**

- Nëse ka arsye për të dyshuar se një person merr, ka marrë ose tenton të marrë përfitime në mënyrë të paligjshme, organet e ndihmës sociale mund t'u bëjnë thirrje inspektorëve të specializuar.
- Përfituesi dhe anëtarët e njësisë familjare duhet të lejojnë asistentët socialë dhe inspektorët e ngarkuar për hetim, të hyjnë në shtëpinë e tyre dhe në rast nevojë në automjetet e tyre, si dhe në vendin e tyre të punës, në praninë e tyre dhe në orare të përshtatshme.
- Përfituesi i ndihmës sociale duhet t'i sigurojë autoritetit të ngarkuar për hetime, sipas kërkesës së këtij të fundit, të gjitha informacionet e nevojshme për përpilimin e fakteve. Ky detyrim vlen edhe për të afërmit dhe familjen, sipas dispozitave të nenit 110 al. 1 dhe 2 të Kodit penal zviceran.
- Në rast se vërehen shkelje, organet e ndihmës sociale e informojnë personin në fjalë për rezultatin e hetimit.
- Për shkelje të ndjekura drejtëpërdrejtë, autoriteti i ngarkuar për hetim denoncon faktet pranë autoriteteve kompetente (Ministère public). Për shkelje të tjera, autoritetet e ndihmës sociale, vendosin gjatë e parashikuara me ligj dhe informojnë Shërbimin e veprimit social (Service de l'action sociale).

5. **Dënim në rast të shkeljes së një detyrimi**

5.1 Dënime administrative (neni 19a ss LIAS)

- Nëse personi nuk paraqet elementet e duhura për të provuar nevojën për ndihmë, komuna mund të refuzojë përkohësisht të merret me këtë çështje.
- Nëse përfituesi i ndihmës sociale nuk respekton një nga detyrimet e tij ligjore, ai rrezikon të marrë një dënim.
- Dënimi merret nga një vendim komunal (ose nga CMS), me shkrim, i motivuar dhe i bëhet me dije përfituesit të ndihmës sociale. Ai tregon dënimin e marrë, kohëzgjatjen e tij (muajt në fjalë), motivin e tij dhe mënyrën se si ai duhet të silltet. Vendimi mund të kundërshtohet pranë Këshillit të Shtetit (Conseil d'Etat) (shih pikën 2.4).

- Janë të mundshme tre lloje dënimesh :
 - 1) Reduktimi shkallë-shkallë i paketës së mirëmbajtjes :
 - Një zvogëlim prej 15% nga paketa e mirëmbajtjes ;
 - Përfjashtimi nga ndihma sociale e dhënia e një ndihme urgjente : paketa e mirëmbajtjes shkon në shumën e mëposhtme mujore : 500 franga.- për të rritur ; 300 franga.- për të mitur nga moshë 12 vjeç ; 220 franga për të mitur nën moshën 12 vjeç ;
 - Përfjashtimi nga ndihma sociale e dhënia e një ndihme urgjente: paketa e mirëmbajtjes shkon në shumën e mëposhtme ditore : 10 franga.- për të rritur e 6 franga - për të mitur ;
 - 2) Marrja në shqyrtim e të ardhurave hipotetike ;
 - 3) Heqja e ndihmës sociale në rast abuzimi të përsëritur.

5.2 Dënimet penale (19d LIAS, 66a, 146 dhe 148a CP)

- Marrja e paligjshme e përfitimeve të ndihmës sociale mund të çojë, sipas ligjit kantonial, në një dënim me një gjobë që shkon deri në 10'000 franga – më së shumti, nëse nuk parashikohet dënim më i ashpër nga ligji federal.
- Sipas ligjit federal një person mund të dënohet për përfitim të paligjshëm të të ardhurave të ndihmës sociale, me privim lirie (burg) një vit ose më shumë ose një dënim me para dhe/ose për mashtrim me një dënim të privimit të lirisë (burg) me pesë vjet ose më shumë ose një dënim me para.
- Nëse përfituesi është i huaj dhe dënohet për mashtrim me ndihmë sociale ose përfitim të paligjshëm të të ardhurave të ndihmës sociale, gjygtari e dënon atë me dënim nga Zvicra për një periudhë nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Me nënshkrimin e tij/ të tyre, nënshkruesi(t) vërteto-n(jnë) kërkesën për ndihmë sociale pranë komunës :

.....

dhe deklaro-n(jnë) që i njohin dispozitat ligjore të përcaktuaramë më lart lidhur me të drejtat dhe detyrimet kryesore të përfituesve, veçanërisht të plotësimit të ndihmës sociale, dhe janë njoftuar për detyrimin për kthimin e shumave të paguara si ndihmë sociale (shiko pikën 3.5 më sipër).

(Mbiemrat, emrat dhe nënshkrimet)

I zoti i dosjes :

Bashkëshorti/partneri :

Fëmijët në moshë madhore :

.....

.....

Vendi dhe data :